



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr.3085/1 prot.

Tiranë më 10.12.2025

Lënda: Mendim mbi një projektvendim

MINISTRISË SË FINANCAVE

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ka marrë në shqyrtim kërkesën tuaj me nr. 16887/1 prot., datë 26.11.2025, administruar me tonën nr. 3085 prot., datë 02.12.2025, me anë të së cilës dërgohet për mendim projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 4/2020 “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare” i shoqëruar me relacionin shpjegues dhe tabelat e përputhshmërisë.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së projektvendimit, konstatojmë se parashikimet që lidhen me mbrojtjen e të dhënave personale janë trajtuar kryesisht në nenin 12 të tij, ku përmenden parimet e proporcionalitetit, mjaftueshmërisë, afatit të përpunimit si dhe masat e sigurisë sa i përket gjurmimit të veprimeve. Parashikime të cilat kanë qenë pjesë edhe e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.613, datë 29.7.2020, të mëparshëm.

Ndërkohë siç dhe mund të jeni në dijeni, nga shkurti i vitit 2025 ka hyrë në fuqi ligji nr.124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (në vijim “Ligji”) i përafruar plotësisht me Rregulloren e Përgjithshme të BE-së për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR), i cili ka shfuqizuar ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe ka sjellë një përmirësim cilësor dhe një rregullim më gjithëpërfshirës të kuadrit ligjor vendas në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Për këtë arsye, çdo përpunim, shkëmbim apo transferim i të dhënave personale duhet të kryhet në përputhje me dispozitat e ligjit të ri dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Parë në këtë frymë, sugjerojmë që në projektvendim të parashikohen dispozita më të detajuara mbi mënyrën e zbatimit të parimeve, roleve dhe përgjegjësi të Autoritetit kompetent dhe institucioneve financiare raportuese të përfshira në këtë proces.

Kështu, sa i përket përmbajtjes së **pikave 3 dhe 4, të nenit 12 të projektvendimit**, sugjerojmë të riformulohen sipas pikave 3, 4, 5 dhe 6, si vijon.

3. *Përpunimi dhe transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale si pjesë e shkëmbimit automatik të informacionit të llogarive financiare, kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.*
4. *Autoriteti kompetent dhe institucionet financiare raportuese shkëmbejnë vetëm të dhënat që janë të domosdoshme dhe të nevojshme për qëllimin e shkëmbimit automatik të informacionit të llogarive financiare, në përputhje me afatet e ruajtjes të përcaktuara në legjislacionin tatimor dhe në marrëveshjet ndërkombëtare përkatëse.*
5. *Autoriteti kompetent dhe institucionet financiare raportuese konsiderohen kontrollues në kuptim të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe kanë detyrimin ligjor për të informuar “mbajtësit e llogarive” mbi natyrën, qëllimin dhe kohën e përpunimit të të dhënave personale për qëllime raportimi, si dhe mënyrën e ushtrimit të drejtave të tyre, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.*
6. *Autoriteti kompetent dhe institucionet financiare raportuese zbatojnë standarde të përshtatshme sigurie, si enkriptimi, kontrolli i aksesit, gjurmimi, auditimi i sistemeve, dokumentimi dhe monitorimi i transmetimit të të dhënave personale, gjatë shkëmbimit automatik të informacionit të llogaritë financiare.”*

Në përfundim, përfshirja e këtyre sugjerimeve në nenin 12 të projektvendimit, sjellin jo vetëm një përputhje më të plotë me nenet përkatëse të Direktivës së Këshillit (BE) 2011/16 e 15 shkurt 2011, “Për bashkëpunimin administrativ në fushën e tatimeve dhe shfuqizimin e Direktivës 77/799/KEE”, e ndryshuar, por dhe një zbatim më efektiv të legjislacioneve respektive vendase, duke kontribuar në një kuadër ligjor më të sigurt, të qëndrueshëm dhe funksional në përputhje me standardet më të larta të mbrojtjes së të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi